



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	
Nr.	prot.

Data: 25.2.2025

Nr: 172

Ora: 14:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA ORA E SHQIPËRISË”, ME KRYETAR Z. ZEF SHTJEFNI, PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND, TË DATËS 11 MAJ 2025**

Sot, më datë 25.2.2025, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën nr. 859 Prot., datë 10.2.2025, me:

- KËRKUES:** Partia politike “Partia Ora e Shqipërisë”, me kryetar Z. Zef Shtjefni
- OBJEKTI:** Regjistrimi i partisë politike “Partia Ora e Shqipërisë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025
- BAZA LIGJORE:** Neni 64, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

**V Ë R E J:**

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 399, datë 5.12.2024, ka caktuar datën 11 Maj 2025, për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

“Partia Ora e Shqipërisë”, nëpërmjet Kryetarit Z. Zef Shtjefni, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvend, që do të zhvillohen më datë 11 Maj 2025.

Data: 25.2.2025 Nr: 172  
Ora: 14:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Ora e Shqipërisë”, me Kryetar Z. Zef Shtjefni, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025”

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, datë 2.12.2024, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Ora e Shqipërisë”, me initiale “P.O.SH.”, me Kryetar Z. Zef Shtjefni, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre.
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Ora e Shqipërisë”, me shkronja nistore “P.O.SH.”, me adresë: Rruga "Irfan Tomini", NISHRAK, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është Z. Zef Shtjefni, me adresë: Rruga “Sali Butka”, H. 1, Ap. 54, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është Zj. Etleva Treska, me adresë: Rruga "Jordan Misja", Pll. 147-1, Ap. 1, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në, është Z. Alkeo Zaçe, me adresë: Rruga "Prokop Mima", Kt. 1, Ap. 5, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Ora e Shqipërisë”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1, të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues i kërkesës, i paraqitur nga “Partia Ora e Shqipërisë”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64, dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, si dhe të Udhëzimit nr. 2, datë 22.1.2025, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 11 Maj 2025”.

## V E N D O S :

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Ora e Shqipërisë”, me kryetar Z. Zef Shtjefni, me shkronjat nistore “P.O.SH.”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 Maj 2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**